



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 800/12 prot.

Datë 12.05.2026

**V E N D I M**

**Nr. 638/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2026 mori në shqyrtim çështjen me:

**Objekt:** Kërkesë për rishikimin e vendimit Nr. 525/2026, datë 22.04.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

**Drejtuar:** Komisionit të Prokurimit Publik  
Adresa: Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë

**Kërkuesi:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a  
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë  
(në krah të Gjykatës së Lartë).

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar,  
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

*“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, dëgjoji relatorin e çështjes, e pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 08.10.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

I.2. Në datën 02.02.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

I.3. Në datën 19.02.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK	0 lekë	s’kualifikuar
2. “KRIJON” SHPK	62,928,000 lekë	s’kualifikuar
3. “MEDFAU” SHPK	63,480,000 lekë	s’kualifikuar
4. “SWISSMED” SHPK	71,484,000 lekë	kualifikuar
5. “E v i t a” SHPK	67,620,000 lekë	s’kualifikuar

I.4. Në datën 02.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi..

I.5. Në datën 12.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa e operatorit ekonomik “MEDFAU” SHPK me numër ankimimi elektronik A/2026/6411, dhe me

Nr. 800/2026 Prot., datë 12.03.2026 ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike

I.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit Nr. 800/1 prot., datë 13.03.2026, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 800 prot, datë 12.03.2026.

I.6. Në datën 12.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6414, dhe me Nr. 815/2026 Prot., datë 13.03.2026 e operatori ekonomik “Evita” SHPK ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

I.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit Nr. 815/1 prot., datë 13.03.2026,

I.7. Në datën 01.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2026/6471, dhe nr. Protokoll 998/2026, datë 01.04.2026, e operatorit ekonomikë “SWISSMED” SHPK, ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për kualifikimin e operatorit ekonomik “Evita” SHPK, si rrjedhojë e shqyrtimit nga KSHA të ankesës me nr. A/2026/6414, datë 12.03.2026 dhe me Nr. 815/2026 Prot., datë 13.03.2026 të operatorit ekonomik “Evita” SHPK.

I.7.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit Nr. 998/1 prot., datë 02.04.2026.

I.8. Në datë 22.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 525/2026, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MEDFAU” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-

2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Evita” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “SWISSMED” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
4. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë “MEDFAU” SHPK dhe “Evita” SHPK, sipas konstatimeve tëshprehura në këtë vendim duke i kualifikuar ata
5. Ngarkohet zyra e financës të kryej veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SWISSMED” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Evita” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [.....]

I.9. Me shkresën nr.2227 prot, datë 05.05.2026, me objekt “Rishqyrtim i vendimit të K.P.P nr.525/2026, datë 22.04.2026”, protokolluar me tonën nr. 800/9 prot., datë 07.05.2026 autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, ka dorëzuar pranë KPP kërkesën për rishikim të vendimit nr.525/2026, datë 22.04.2026.

## Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

### Arsyeton

II.1. Në kuptim e zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. (neni 24 i LPP).

II.1.1. Me shkresën nr.2227 prot, datë 05.05.2026, me objekt “Rishqyrtim i vendimit të K.P.P nr.525/2026, datë 22.04.2026”, protokolluar me tonën nr. 800/9 prot., datë 07.05.2026 autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, ka dorëzuar pranë KPP kërkesën për rishikim të vendimit nr.525/2026, datë 22.04.2026, duke pretenduar ndër të tjera:

*[...] Referuar këtij vendimi është e rëndësishme që të qartësojmë se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i krijuar për vlerësimin e procedruës së sipërcituar nuk ka qëllim në vetvete të përcaktojë nëse "UREA" është një parametër i justifikuar klinikisht dhe është ose jo i domosdoshëm në praktikën klinike, por është krijuar për të vlerësuar operatorët ekonomikë pjesmarrës nëse me dokumentacionin e paraqitur në SPE në datën dhe orën e hapjes së ofertave përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara në DST ose jo dhe në asnjë moment nuk është kryer interpretim i pjesshëm dhe i fragmentarizuar i dokumentacionit teknik sic ju jeni shprehur në këtë vendim në faqen 22 të tij. Arsyeja e skualifikimit e evidentuar nga ana e KVO ka qënë e qartë sipas së cilës pajisjet e ofertuar dhe artikujt pjesë e setit nuk përmbushin të gjitha specifikimet teknike të kërkuara pasi nuk përfshijnë kryerjen e parametrin "UREA", parametër ky i parashikuar në shtojcën 6 "Formulari i Specifikimeve Teknike", specifikime të cilat parashikohen nga autoriteti përfitues sipas nevojave të përcaktuara nga ata. Fakti që në specifikime teknike të paraqitura pranë OBP nga autoriteti përfitues është kërkuar që pajisja dhe seti i ofertuar duhet të kryejnë ndërmjet të tjerave dhe parametrin "UREA", na bën ne si KVO të detyrueshëm vlerësimin e plotë të pajisjes dhe artikujve pjesë të setit nëse përmbushin kryerjen e të gjitha parametrave të përcaktuara.*

*Nisur nga arsyetimi i KPP ju sjellim në vëmendje që evidentimi i ureas në dokumentin "operator\_guide\_RP500" në seksionin që lidhet me testimin e interferencës së laktatit, në faqen 452, nuk tregon që parametri "UREA" kryhet nga sistemi i ofertuar, por tregon që kur testohet Interferenca (nderveprimi) i laktatit me lëndët ose gazet e tjera (në këtë rast UREA) nuk krijon efekt në rezultat. Rjedhimisht kjo nuk do të thotë që sistemi i ofertuar e kryen parametrin "UREA" por Urea është testuar si substancë interferuese dhe rezultati tregon që nuk ndikon në matjen e laktatit.*

*Në përfundim të arsyetimit të mësipërm parashitrojmë që kërkesat e autoriteti përfitues kanë qënë mjaft të qarta dhe nëpërmjet specifikimeve teknike të përgatitura kanë kërkuar që pajisë dhe seti duhet të bëjnë ndërmjet të tjerave dhe parametrin "UREA" dhe fakti që ata e kam përfshirë në kërkesat minimale të specifikimeve teknike do të thotë që është parametër*

*nevojshëm. Shpallja fitues e një operatori ekonomik i cili ka paraqitur pajisje dhe set të ci nuk e bëjnë parametrin e kërkuar "UREA" rrjedhimisht do të sjellë problematika në zbatim kontraës objekt prokurimi.*

*Për sa më sipër, kërkojmë nga KPP:*

*1. Rishqyrtimin e menjëhershëm të vendimit nr. Nr 525/2026, datë 22.04.2026 në përp me parashikimet ligjore të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndry cituar më sipër dhe marrjen e vendimit final mbi vlerësimin e kësaj proc kompetencë që në këtë faze i takon vetëm KPP dhe jo strukturave të AK....”.*

II.2.2. KPP në lidhje me vendimarrjen gjykon se ligjvënësi ka parashikuar rregulla strikte mbi procedurën e shqyrtimit të ankesave si nga autoriteti kontraktor ashtu edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik, në cilësinë e organit më të lartë të shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike, në zbatim edhe të nenit 24/3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili parashikon “Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.”

III.2.3.Lidhur me argumentat e paraqitura në kërkesën e autoritetit kontraktor KPP sqaron se:

Në bazë të nenit 24 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve publike, i pavarur, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe merr vendime për to. Vendimet e KPP-së kanë karakter administrativisht përfundimtar, sipas nenit 30 të ligjit nr. 162/2020, dhe mund të kundërshtohen vetëm në rrugë gjyqësore, sipas nenit 121 të këtij ligji. Për rrjedhojë, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, në cilësinë e autoritetit kontraktor/organit qendror blerës që ka zhvilluar procedurën, nuk ka asnjë kompetencë ligjore për të kërkuar “rishqyrtim” të vendimit të KPP-së përmes një shkresë administrative. Një kërkesë e tillë nuk gjen mbështetje as në ligjin nr. 162/2020, as në VKM nr. 285/2021, as në Kodin e Procedurave Administrative. Në këtë kuptim, shkresa e autoritetit kontraktor nr 2227 prot., datë 05.05.2026, nuk mund të trajtohet si mjet ligjor administrativ. Ajo nuk është ankim, sepse ligji nuk parashikon ankim administrativ ndaj vendimit të KPP-së pranë vetë KPP-së. Nuk është kërkesë për korigjim gabimi material, sepse nuk kërkon korigjim të ndonjë pasaktësie formale, por kundërshton thelbin e vendimarrjes. Nuk është as kërkesë për sqarim, sepse nuk kërkon interpretim të dispozitivit, por synon zëvendësimin e tij. Kjo e bën shkresën proceduralisht të papranueshme. Nëse autoriteti kontraktor nuk pajtohet me vendimin e KPP-së, rruga ligjore është ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit. Çdo përpjekje për të krijuar një “rrugë të ndërmjetme” përmes korrespondencës institucionale nuk prodhon efekt pezullues, nuk krijon detyrim rishqyrtimi dhe nuk cenon fuqinë detyruese të vendimit të KPP-së.

Në bazë të nenit 24 të ligjit nr. 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, organ i pavarur, i cili shqyrton ankesat dhe merr vendime për to. OBP, në këtë procedurë, ka qenë autoritet kontraktor/organ qendror blerës që ka zhvilluar procedurën dhe ka kryer vlerësimin përmes Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Për rrjedhojë, OBP është subjekt i kontrollit administrativ të KPP-së, dhe jo organ kontrollues mbi KPP-në.

Ky raport nuk është i paqartë. KVO vlerëson ofertat. KPP kontrollon ligjshmërinë e këtij vlerësimi. OBP nuk mund të paraqitet pas vendimit si një instancë rishikuese e arsyetimit të KPP-së.

Kjo shkresë, në thelb, tenton ta vendosë autoritetin kontraktor në pozicionin e një organi që kërkon llogari nga organi më i lartë administrativ i ankimit. Ky pozicion nuk ekziston në ligj. Është institucion juridik imagjinar.

Në një procedurë ankimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të paraqesë argumente, dokumentacion dhe shpjegime gjatë shqyrtimit administrativ. Por pas nxjerrjes së vendimit administrativisht përfundimtar të KPP-së, ai nuk mund të kërkojë rihapjen e themelit të çështjes, përveçse në kushtet e mjeteve ligjore të parashikuara shprehimisht nga ligji.

Edhe nëse kjo shkresë do të lexohej në dritën e institutit të “rishikimit” sipas Kodit të Procedurave Administrative, ajo përsëri nuk plotëson kushtet ligjore.

Sipas Kodit të Procedurave Administrative, rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm administrativ që kërkon anulimin ose ndryshimin e një akti kur ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit, dhe vetëm nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë, të cilat kanë rëndësi për çështjen dhe nuk dihen apo nuk mund të dihen gjatë procedurës administrative.

Në rastin konkret, OBP nuk paraqet asnjë provë të re. Nuk paraqet asnjë dokument teknik të ri të panjohur më parë. Nuk paraqet asnjë rrethanë të re objektive. Përkundrazi, shkresa mbështetet në një interpretim të ri të të njëjtit dokument “operator\_guide\_RP500”, të cilin KPP e ka administruar dhe analizuar në vendimin nr. 525/2026.

Një interpretim i vonuar nuk është provë e re. Një lexim alternativ i të njëjtit dokument nuk është rrethanë e re. Një pakënaqësi institucionale me vendimin nuk është shkak rishikimi.

Për rrjedhojë, edhe nën standardin e Kodit të Procedurave Administrative, kërkesa është e pambështetur.

#### *Mbi objektin real të vendimit nr. 525/2026 dhe keqparaqitjen e tij nga OBP*

Vendimi nr. 525/2026 i KPP-së nuk ka riformuluar dokumentet e tenderit. Nuk ka fshirë parametrin “UREA” nga specifikimet teknike. Nuk ka shpallur se parametri “UREA” është klinikisht i panevojshëm. Nuk ka vendosur që operatorët ekonomikë mund të mos përmbushin specifikimet teknike.

Vendimi ka bërë diçka krejt tjetër: ka kontrolluar nëse arsyeja konkrete e skualifikimit e artikuluar nga KVO ishte e mbështetur në dokumentacionin e ofertës së paraqitur në SPE.

Për operatorin ekonomik MEDFAU, arsyeja e skualifikimit ishte mungesa e pretenduar e parametrin “UREA” në dokumentacionin teknik të pajisjes dhe të setit. KPP konstatoi se vlerësimi i KVO-së ishte i pjesshëm dhe i fragmentuar, pasi dokumentacioni i paraqitur duhej lexuar në tërësi, jo në mënyrë të izoluar. KPP vlerësoi se në dokumentin “operator\_guide\_RP500”, në seksionin për testimin e interferencës së laktatit, evidentohet UREA, çka rrëzon përfundimin kategorik të KVO-së se parametri mungonte në dokumentacionin teknik. Pra, KPP nuk ka thënë: “UREA nuk duhet”. KPP ka thënë: “KVO nuk provoi mungesën e UREA-s mbi bazën e një shqyrtimi të plotë të dokumentacionit.”

Kjo është diferencë themelore. Shkresa juaj e anashkalon këtë dallim dhe, pikërisht këtu, bie në gabim.

Në vend që të pranojë se KVO ka dhënë një arsyetim të pamjaftueshëm dhe të fragmentarizuar, OBP përpiqet ta zëvendësojë pas vendimit arsyen e skualifikimit me një arsyetim të ri teknik: se përmendja e UREA-s në testimin e interferencës nuk provon domosdoshmërisht kryerjen e analizës së UREA-s nga sistemi i ofertuar.

Ky është argument i ri i thelluar teknik, i paraqitur pas vendimit të KPP-së. Ai nuk është baza e qartë dhe e plotë e skualifikimit të bërë nga KVO në momentin procedural përkatës. KPP kontrollon ligjshmërinë e aktit të skualifikimit sipas arsyeve të dhëna në atë akt, jo sipas arsytimit të mëvonshme që autoriteti kontraktor ndërton pasi humbet çështjen.

Administrata nuk mund të skualifikojë me një arsye dhe ta mbrojë skualifikimin më pas me një arsye tjetër. Ky është standard fillestar i arsyetimit administrativ. Edhe këtë duhet ta themi, sepse duket se manuali i “**arsyetimit pas humbjes**” po qarkullon me shumë sukses.

#### *Mbi pretendimin teknik për parametrin “UREA”*

OBP pretendon se evidentimi i UREA-s në dokumentin “operator\_guide\_RP500”, në pjesën e testimin të interferencës, nuk provon që sistemi i ofertuar kryen analizën “UREA”, por vetëm që UREA është përdorur si substancë interferuese në testimin e laktatit.

Edhe sikur ky pretendim të trajtohej si argument teknik, ai nuk mund të prodhojë rishqyrtim administrativ të vendimit të KPP-së.

Së pari, ky pretendim i përket themelit teknik të çështjes dhe mund të ngrihet vetëm në rrugën e ankimit gjyqësor ndaj vendimit të KPP-së.

Së dyti, ky pretendim nuk përbën provë të re. Ai është një interpretim i ndryshëm i dokumentacionit të njëjtë.

Së treti, në njoftimin e skualifikimit të MEDFAU, KVO nuk ka bërë një analizë të detajuar për dallimin ndërmjet “UREA si parametër matjeje” dhe “UREA si substancë interferuese”. KVO është mjaftuar me përfundimin se dokumentacioni nuk përfshin/kryen parametrin UREA. KPP

e ka kontrolluar pikërisht këtë arsye dhe ka gjetur se ajo nuk qëndron mbi bazën e një shqyrtimi të plotë të dokumentacionit teknik.

Së katërti, nëse autoriteti kontraktor vlerësonte se duhej një provë teknike specifike, e qartë dhe e ndarë për kryerjen e analizës UREA nga sistemi, kjo duhej të ishte formuluar qartë në dokumentet e tenderit, me mënyrën konkrete të provimit të saj. Nuk mund të kërkohej pas hapjes së ofertave një nivel provimi që dokumentet e tenderit nuk e kanë përkufizuar në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme.

Në procedurat e prokurimit publik, operatorët ekonomikë nuk përjashtohen mbi bazë hamendësimesh të mëvonshme teknike. Përjashtohen vetëm mbi bazën e kritereve të qarta, të publikuara dhe të verifikueshme.

Në shkresën tuaj kërkohej që Agjencia e Prokurimit Publik të konfirmojë se dokumentet e tenderit janë “**ligji i procedurës**” dhe të ndërhyjë për “**unifikimin e praktikës administrative**”.

Komisioni sqaron se APP nuk është organ epror i KPP-së dhe nuk ka kompetencë të rishikojë, pezullojë, korrigjojë apo zëvendësojë vendimmarrjen e KPP-së në një çështje konkrete ankimi.

Ligji nr. 162/2020 ka ndarë qartë funksionet institucionale: APP mbikëqyr sistemin dhe ushtron kompetencat e saj në fushën e mirëzbatimit të kuadrit ligjor. KPP është organi më i lartë administrativ për shqyrtimin e ankesave dhe vendimmarrjen mbi to. Përfshirja e APP-së në dijeni nuk krijon një forum të tretë kontrolli. Si rjedhje, nuk mjafton t’i dërgosh një shkresë APP-së për të prodhuar një “Gjykatë Administrative të re”. Ligji nuk funksionon me CC institucionale.

Nëse OBP kërkon udhëzim të përgjithshëm për praktika të ardhshme, kjo është çështje tjetër. Por asnjë udhëzim, rekomandim apo qëndrim i APP-së nuk mund të ndërhyjë në një vendim konkret të KPP-së, administrativisht përfundimtar.

#### *Mbi standardin e Direktivës 2014/24/BE*

Ligji nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021 janë të përafuara pjesërisht me Direktivën 2014/24/BE, Direktivën 2014/25/BE dhe direktivat e mjetëve juridike në fushën e prokurimit publik. Kjo do të thotë se interpretimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me parimet e së drejtës së Bashkimit Europian.

Neni 18 i Direktivës 2014/24/BE kërkon që autoritetet kontraktore të trajtojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese, si dhe të veprojnë në mënyrë transparente dhe proporcionale; po kjo dispozitë ndalon projektimin e prokurimit për të ngushtuar artificialisht konkurrencën.

Neni 42 i Direktivës përcakton se specifikimet teknike duhet të sigurojnë akses të barabartë për operatorët ekonomikë dhe nuk duhet të krijojnë pengesa të pajustificuara ndaj hapjes së prokurimit ndaj konkurrencës.

Neni 56, pika 3, i Direktivës 2014/24/BE lejon që autoritetet kontraktore të kërkojnë paraqitjen, plotësimin, sqarimin ose kompletimin e informacionit/dokumentacionit të dorëzuar, kur ai

është ose duket i paplotë, i gabuar ose kur mungojnë dokumente të caktuara, me kusht që kjo të bëhet në respekt të barazisë dhe transparencës.

Ky standard european nuk mbështet formalizmin e verbër të KVO-së dhe as tentativën e OBP-së për të justifikuar pas vendimit një skualifikim të pambështetur mjaftueshëm. Direktiva kërkon qartësi të kritereve, proporcionalitet të specifikimeve dhe verifikim real të ofertës. Nuk kërkon që një operator të përjashtohet sepse KVO lexon një dokument me një sy dhe pastaj kërkon ndihmë pas vendimit.

#### *Mbi jurisprudencën e GJED-së*

Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European ka vendosur një vijë të qartë ndërmjet:

1. Sqarimit/verifikimit të dokumentacionit ekzistues, që lejohet nëse nuk ndryshon ofertën dhe respekton trajtimin e barabartë.
2. Ndryshimit material të ofertës pas afatit, që nuk lejohet.

Në çështjen C-599/10, SAG ELV Slovensko, GJED ka pranuar se sqarimet mund të kërkohen kur nuk çojnë në paraqitjen e një oferte të re dhe respektojnë barazinë ndërmjet operatorëve.

Në çështjen C-336/12, Manova, Gjykata ka pranuar mundësinë e kërkimit të dokumenteve që provojnë një gjendje ekzistuese përpara afatit të dorëzimit, duke ruajtur kufirin që nuk mund të krijohet apo ndryshohet substanca e ofertës pas afatit.

Në çështjen C-387/14, Esaprojekt, standardi european është se plotësimi i mëvonshëm nuk mund të përdoret për të ndryshuar substancën e ofertës apo për të krijuar kapacitete që nuk ekzistonin në momentin e ofertimit.

Në çështjen C-131/16, Archus dhe Gama, Gjykata ka ritheksuar kufirin ndërmjet sqarimit të lejueshëm dhe ndryshimit të palejueshëm të ofertës.

Gjithashtu KPP, sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor, se neni 30, pika 2, e Ligjit 162/2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar thekson: “2. *“Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji”*.”

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

## Vendos:

1. Të mos pranojë kërkesën e autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, për rishikim të vendimit të KPP nr.525/2026, datë 27.04.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

